



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2917 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

**VENDIM**

**Nr. 23, Datë 29. 02. 2024**

**Për një shtesë në VKB nr.70, datë 14.12.2023 “Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024” dhe përdorim të fondit të akorduar nga MSHMS**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.565/1, datë 31.01.2024 “Transferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në qarqe dhe bashki”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

1. Miratimin e një shtese në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024 në:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.1 Art.606 në shumën 3,901,299 lekë. Kodi i Projektit 91307AH.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të akordura në:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 2,126,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për pagat e punonjësve të projekteve: “Tungjatjeta jetë” në shumën 568,760 lekë dhe “Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve” në shumën 1,557,240 lekë.
- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 355,042 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për punonjësit e projekteve: “Tungjatjeta jetë” në shumën 94,983 lekë dhe “Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve” në shumën 260,059 lekë.
- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 në shumën 1,420,257 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për pagesa të punonjësve me kohë të pjesshme në shumën 912,000 lekë, për trajnim të stafit të projektit në shumën 8,257 lekë dhe për mbështetje ekonomike të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shumën 500,000 lekë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

103  
Nr. 2914/Prot  
Dt. 12.01.24

Nr. 216/ Prot.  
24

Lezhë, më 11.03.2024

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar"; si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 23, datë 29.02.2024 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë në VKB nr 70, datë 14.12.2023 "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024 "dhe përdorim të fondit të akorduar nga MSHMS".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

